



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2022:031331  
Datë: 22.07.2022  
Numri i dokumentit: 03258355

**C.nr.101/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditësit A. (R.) T. nga Rahoveci, kundër të paditurve Z. R., B. R., S. R., B. M. e lindur R., D. R., S. R., të gjithë nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar av. G. Sh. nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 3,000.00 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **14.07.2022**, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit, **SI E BAZUAR**.

**VËRTETOHET** se paditësi **A. (R.) T.** nga Rahoveci, është pronar i parcelave kadastrale nr. **1565-1**, në sipërfaqe prej **304 m<sup>2</sup>**, nr. **1565-7**, në sipërfaqe prej **192 m<sup>2</sup>**, nr. **1565-6-6**, në sipërfaqe prej **147 m<sup>2</sup>**, si dhe nr. **1565-5**, në sipërfaqe prej **214 m<sup>2</sup>**, **ZK Rahovec**, në bazë të parashkrimit fitues, çka të **paditurit** Z. R., B. R., S. R., B. M. e lindur R., D. R., S. R., të gjithë nga Rahoveci, janë të **obliguar** që të pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që paditësi të regjistrohet si pronar në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Rahovec, ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimit të përmbarimit të detyrueshëm.

**Shpenzimet procedurale i bartë paditësi.**

### A r s y e t i m

Paditësi A. (R.) T., ka ushtruar padi kundër të paditurit Z. R., B. R., S. R., B. M. e lindur R., D. R., S. R., për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar disa seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilat janë paraqitur paditësi A. T. personalisht, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve Av. G. Sh..

Paditësi A. T., ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke theksuar faktin se me kontratë gojore mbi shitblerjen të patundshmërisë ka blerë parcelën kadastrale nr. 1565-1, në sipërfaqe prej 304 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, e cila parcelë evidentohet në emër të paraardhësit të këtu të paditurve Xh. B. R., parcelën kadastrale nr. 1565-7, në sipërfaqe prej 192 m<sup>2</sup>, e cila parcelë evidentohet në emër të këtu të paditurit të parë Z. R., parcela kadastrale nr. 1565-6, në sipërfaqe prej 147 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, e cila parcelë evidentohet në emër të këtu të paditurit të dytë B. R. si dhe parcelën kadastrale nr. 1565-5, në sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, e cila parcelë evidentohet në emër të këtu të paditurit të tretë S. R., të njëjtën ditë unë

me të paditurit jemi marrë veshë që kontratën interne për vërtetimin e saj të vërtetohet pranë atëherë Gjykatës Komonale në Rahovec dhe e njëjta patundshmëri të regjistrohet në Librat Kadastrale pranë organit kompetent të njëjtat parcela unë i kam përdorur pa ndërprerë me mirëbesim, parcelat kontestuese nuk kanë mundur të barten në emrin tim deri me tani pasi që njëra nga parcela evidentohet në emër të paraardhësit të këtu paditurve Xh. B. R. ish nga Rahoveci, ku të paditurit deri më tani nuk e kanë kryer shqyrtimin e trashëgimisë. Po ashtu ritheksoi se i ka kryer të gjitha obligimet ndaj të paditurve duke përfshirë edhe pagesën për shitblerjen, ndërsa të paditurit që nga momenti i kontraktimit i kanë dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim të lirë parcelat që nga ajo kohë nuk është penguar nga askush.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjykata së bashku me ekspertin gjeometër që ka dalë në vendin e ngjarjes ka vërtetuar faktin relevant se ai që nga koha e shitblerjes e deri më sot është në shfrytëzim të parcelave që janë objekti i këtij kontesti dhe deri më sot nuk është penguar nga askush andaj i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve avokati G. Sh. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të datës 16.06.2022, pretendimet e paditësit qëndrojnë në tërësi si në padi dhe nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe nuk i kundërshtoj propozimit të paditësit që gjykata së bashku me ekspertin gjeometër të dalin në vendin e ngjarjes për të vërtetuar gjendjen faktike.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjykata ka vërtetuar faktin relevant pas daljes në vend së bashku me ekspertin gjeometër gjegjësisht që paditësi është në posedim dhe shfrytëzim të parcelave duke mos u penguar nga askush që nga momenti i marrëveshjes gojore mbi shitblerje, po ashtu janë krijuar të gjitha prestimet që kanë dalë nga kontrata gojore duke përfshirë pagesën për shitblerje, andaj në fund i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Për të vërtetuar faktet vendimtare, gjykata i ka zbatuar këto prova: ka bërë shikimin në certifikatat të pronës të datës 18.01.2022, ka bërë shikimin në dëshmi vdekje për të ndjerin Gj. R., të datës 27.01.2021, ka bërë shikimin në dëshmi vdekje për të ndjerin M. R. të datës 27.01.2021, ka bërë shikimin në ekspertizën së bashku me skicën e terrenit së ekspertit gjeometër nga G.-L. prej datës 14.07.2022.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.**

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.01.2022, për parcelën kadastrale nr. 1565-1, në sipërfaqe prej 304 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, vërtetohet se evidentohet në emër të paraardhësit të të paditurve Xh. (B.) R..

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.01.2022, për parcelën kadastrale nr. 1565-5, në sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, vërtetohet se evidentohet në emër të të paditurit S. (Xh.) R..

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.01.2022, për parcelën kadastrale nr. 1565-6, në sipërfaqe prej 147 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, vërtetohet se evidentohet në emër të të paditurit B. (Xh.) R..

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.01.2022, për parcelën kadastrale nr. 1565-7, në sipërfaqe prej 192 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, vërtetohet se evidentohet në emër të të paditurit Z. (Xh.) R..

Me shikimin në dëshmi vdekje për të ndjerin Gj. R., të datës 27.01.2021, vërtetohet se prej trashëgimtarëve ka lënë Z. R., M. R., B. R., S. R., B. M..

Me shikimin në dëshmi vdekje për të ndjerin M. R. të datës 27.01.2021, vërtetohet se prej trashëgimtarëve ka lënë D. R., dhe S. R..

Me shikimin në ekspertizën dhe skicës së terrenit të kompanisë G.-L. të datës 14.2022, është konstatuar se: parcelat kontestuese nr. 1565-1, në sipërfaqe prej 304 m<sup>2</sup>, nr. 1565-7, në sipërfaqe prej 192 m<sup>2</sup>, nr. 1565-6-6, në sipërfaqe prej 147 m<sup>2</sup>, si dhe nr.1565-5, në sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, sipas evidencës në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Rahovec, evidentohet në emër të paraardhësit të të paditurve Xh. (B.) R., S. (Xh.) R., B. (Xh.) R., Z. (Xh.) R., R., B. M..

Si fakte relevante në këtë çështje juridike, gjykata merr për bazë se është argumentuar fakti se paditësi është në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim dhe paraardhësit e të paditurve i ka pranuar të hollat, dhe se të paditurit nuk ka kundërshtuar që paluajtshmëria të bartet në emër të paditësit.

Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore me dispozitën e nenit 40. 1 parasheh se: ***Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të,*** sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se paditësi në shfrytëzim të pronës është vendosur posedim të ligjshëm dhe mirëbesim rreth mbi 20 vite, i cili kusht është plotësuar edhe me LTHMPJ-së, sipas dispozitës së nenit 28. 4.

Në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 28. 4 të LTHMPJ-së, dhe nenit 40. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, si dhe neneve 143 dhe 254 dhe 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

**Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**C.nr.101/2022, më 14.07.2022**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Gjyqtari**  
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.